



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "PBC" Sh.P.K. të datës 12.04.2024 si dhe kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Rener" Sh.P.K. të datës 12.04.2024, kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore ritender lot 1" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "PBC" Sh.P.K. e datës 12.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore ritender lot 1" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.
- II. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Rener" Sh.P.K. e datës 12.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore ritender lot 1" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.
- III. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "PBC" Sh.P.K. me datë 12.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore ritender lot 1" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.

Operatori ekonomik "Rener" me datë 12.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Digjitalizimi i proceseve edukativo-arsimore ritender lot 1" me nr. të prokurimit 616-24-97-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesave për rishqyrtim të parashtruesve është gjetur se kërkesat janë të lejuara dhe janë parashtruar brenda afatit nga personat e autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesat. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesave.

Pretendimet e operatorit ekonomik "PBC" Sh.P.K. janë formuluar si në vijim: "Në dosjen e tenderit, në specifikat teknike të detyrueshme Aneks 1, NUK është kërkuar të ofrohet "përmbajtje të njërive mësimore të listuara konform kurrikules së Kosovës" e as "njësi mësimore të vendosura në një bibliotekë digjitale në formë të një software elektronik të dedikuar dhe të sigurt online dhe offline" sic është theksuar në arsyetimin e vendimit të datës 08 prill 2024. Por në dosjen e tenderit, specifikat teknike të detyrueshme Aneks 1, kërkesa ka qenë "Sherbimi I digjitalizimit përfshinë: 1. Funksionimi i rregullt i platformes 24/7; 2. Siguria e plote e të dhenave në platforme; 3. Mirembajtja teknike e secilit funksionalitet ekzistues (module) që garanton mbarevajtjen e plote të të gjitha funksioneve ekzistuese; 4. Garantimi i ngarkimit dhe shkarkimit të të gjitha materialeve të nevojshme për funksionimin e plote të platformës; 5. Ofrimi i perkrahjes teknike në rast të problemeve teknike që pamundesojnë kyqjen dhe përdorimin e platformës; 6. Dorezimi i të gjitha të dhenave të platformes (përfshirë arkivoen) në format dixhital të migrueshem pas përfundimit të këtij aktiviteti të njesia e kërkeses.; 7. Ofrimin e trajnimit të stafit mësimdhënës të nivelit I-V dhe VI-IX rreth përdorimi të platformës; 8. Ofrimin e trajnimit të stafit mësimdhënës të nivelit X-XII rreth përdorimi të platformës; Sqarim shtesë: Në specifikacion janë numri I nxënësve të IEA në Prishtinë por vazhdimisht ka lëvizje të nxënësve shkuare/ardhje. Devijimi I lejuar /-30% nga vlera e kontrates". Provë 1: Faqja 17 e dosjes së tenderit, Aneksi 1. Specifikimet teknike të dëmtueshme e nënvizuar me ngjyre të verdhë. Pra, siç shihet më sipër, vendimi i juaj e datës 08 prill 2024, është në kundërshtim me kriteret e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit dhe si i tillë shkel paragrafin 3 i nenit 52 dhe paragrafin 4 të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenin 40 dhe nenin 47.7 të Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik".

Lidhur me pretendimet ankimore të "PBC" Sh.P.K. duhet sqaruar se në dosjen e tenderit përkatësisht në paramasën e cila është pjesë e dosjes së tenderit dhe e ndërlidhur me aneksin 1 të saj apo specifikimet teknike të detyrueshme është përcaktuar si në vijim:

Shkolla fillore nga klasa 1-5 dhe 6-9					
Paramasa	Njësia	Sasia	Çmimi(€) me TVSH	Total(€)	
1 Regjistrimi i përdoruesve në databazë (biblotekë) të programit	Person	29,600.00		€	-
2 Trajnimi i përdoruesve (ndihma teknike) për përdorimin e programit	Person	29,600.00		€	-
MATERIALE MËSIMORE SHKENCORE AUDIOVIZUALE DIGJITALE PËR PROGRAMET LËNDORE ME SPECIFIKIME TEKNIKE -Kohezgjatja -nje vit shkollor (12 muaj) A. Mjet mesimor në formën e njësive mësimore digjitale për lëndët bazë dhe ato shkencore të shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët (minimum gjysma e lëndëve mësimore-të dokumentohet para komisionit vlerësues). a). Njësitë mësimore duhet të jenë cilësore dhe të përshtatshme për përdorim si materiale didaktike ndihmuese për konkretizimin e kurrikulës së re; • Të përmbajnë shumicën e njësive mësimore të programit lëndor (minimum 80 % e mësimëve kurrikulare për lëndët e caktuara-të prezantohet para komisionit vlerësues) • Të realizuara në shqip; • Të realizuara profesionalisht në formën e videoeve të animuara me teknika profesionale të përparuara (mesatarja e një video mësimi 4-5 minuta-të prezantohet para komisionit vlerësues); • Me përmbajtje të lartë konkretizuese të informacionit didaktik e shkencor; • Të shoqëruara me ushtrime ose materiale të tjera didaktike të dobishme për përdorim didaktik në klasë dhe në shtëpi (lista e ushtrimeve dhe materialeve ndihmuese prezantohet para komisionit vlerësues); • Të dobishme edhe në mësimdhënie e nxënie për nxënës me nevojë të veçantë. b). Njësitë mësimore të jenë të vendosura në një bibliotekë digjitale në formën e një softueri elektronik të dedikuar dhe të sigurtë online ose offline që të: • Përmbajë njësitë mësimore të listuara konform kurrikulës dhe planprogramit të definuar nga MASHT;	Person	29,600.00		€	-

Nga analizimi me kujdes i pretendimeve ankimore të parashtruesit rezulton se për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti që i njëjti nuk ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit për “njësi mësimore të vendosura në një bibliotekë digjitale në formën e një softueri elektronik të dedikuar dhe të sigurtë online dhe offline...”. Pra parashtruesi nuk e konteston që nuk e përmbushë këtë kërkesë mirëpo i njëjti pretendon që kjo kërkesë nuk ekziston fare në dosjen e tenderit. Megjithatë figura më sipër e cila është marrë nga paramasa si pjesë integrale e dosjes së tenderit e cila ndërlidhet me aneksin 1 – secifikimet teknike të detyrueshme, mund të konfirmohet që kërkesa e kontestuar nga parashtruesi jo vetëm që ka qenë pjesë e dosjes së tenderit mirëpo e njëjta ka qenë e formuluar po ashtu në mënyrë shumë të kjartë sipas LPP. Për më tepër, parashtruesit kanë pasur mundësi që të kërkojnë edhe sqarime shtesë para hapjes së tenderëve nëse kanë pasur diçka të pakjartë lidhur me këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Përndryshe kërkesa si e tillë është e vendosur pa dyshim në dosjen e tenderit dhe nuk është aspak kontestuese (as për vet parashtruesin) se kjo kërkesë e dosjes së tenderit nuk është përmbushur nga parashtruesi. Rrjedhimisht arsyet për eliminimin e parashtruesit nga aktiviteti i prokurimit sipas njoftimit mbi vendimin dhe rekomandimit të komisionit vlerësues janë qëndrueshme. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore janë në tërësi të pabazuara dhe kërkesa për rishqyrtim duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Rener” Sh.P.K. janë si në vijim: “Arsyetimi i dhënë për anulim të ofertës sonë për LOT 1, se ne nuk kemi përmbushur specifikat teknike të detyrueshme nga Aneksi 1, nuk qëndron, sepse në Aneksin 1 të specifikave teknike të detyrueshme, këto kërkesa nuk janë përcaktuar. Në Aneksin 1 të dosjes së tenderit, janë tetë (8) pika, asnjëra nga to nuk përkon me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për eliminim të ofertës sonë. Për këto 8 pikat, AK ka kërkuar dorëzimin e Aneksit 1 të nënshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi ekonomik dhe ne kemi plotësuar këtë kërkesë duke dorëzuar Aneksin 1 të nënshkruar dhe të vulosur”.

Lidhur me pretendimet ankimore të “Rener” Sh.P.K. duhet sqaruar se në dosjen e tenderit përkatësisht në paramasën e cila është pjesë e dosjes së tenderit dhe e ndërlidhur me aneksin 1 të saj apo specifikimet teknike të detyrueshme është përcaktuar si në vijim:

Shkolla fillore nga klasa 1-5 dhe 6-9					
Paramasa	Njësia	Sasia	Çmimi(€) me TVSH	Totali(€)	
1 Regjistrimi i përdoruesve në databazë (bibliotekë) të programit	Person	29,600.00	€	-	-
2 Trajnimi i përdoruesve (ndihma teknike) për përdorimin e programit	Person	29,600.00	€	-	-
MATERIALE MËSIMORE SHKENCORE AUDIOVIZUALE DIGJITALE PER PROGRAMET LËNDORE ME SPECIFIKIME TEKNIKE -kohezgjatja -nje vit shkollor (12 muaj) A. Mjet mesimor në formën e njësive mësimore digjitale për lëndët bazë dhe ato shkencore të shkollimit filior dhe të mesem të ulët (minimum gjysma e lëndëve mësimore-të dokumentohet para komisionit vlerësues). a). Njësitë mësimore duhet të jenë cilësore dhe të përshtatshme për përdorim si materiale didaktike ndihmuese për konkretizimin e kurrikulës së re; • Te përmbajnë shumicën e njësive mësimore të programit lëndor (minimum 80 % e mësimëve kurrikulare për lëndët e caktuara-të prezantohet para komisionit vlerësues) • Te realizuara në shqip; • Te realizuara profesionalisht në formën e videoeve të animuara me teknika profesionale të përparuara (mesatarja e një video mësimi 4-5 minuta-te prezantohet para komisionit vlerësues); • Me përmbajtje të lartë konkretizuese të informacionit didaktik e shkencor; • Te shoqëruara me ushtrime ose materiale të tjera didaktike të dobishme për përdorim didaktik në klase dhe në shtëpi (lista e ushtrimeve dhe materialeve ndihmëse prezantohet para komisionit vlerësues); • Te dobishme edhe në mësimdhënie e nxënie për nxënës me nevoja të veçanta. b). Njësitë mësimore të jenë të vendosura në një bibliotekë digjitale në formën e një softueri elektronik të dedikuar dhe të sigurtë online ose offline që të: • Përmbajë njësitë mësimore të listuara konform kurrikulës dhe planprogramit të definuar nga MASHT;	Person	29,600.00	€	-	-

Nga analizimi me kujdes i pretendimeve ankimore të parashtruesit rezulton se për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti që i njëjti nuk ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit për “njësi mësimore të vendosura në një bibliotekë digjitale në formën e një softueri elektronik të dedikuar dhe të sigurtë online dhe ofline...”. Pra parashtruesi nuk e konteston që nuk e përmbushë këtë kërkesë mirëpo i njëjti pretendon që kjo kërkesë nuk ekziston fare në dosjen e tenderit. Megjithatë figura më sipër e cila është marrë nga paramasa si pjesë integrale e dosjes së tenderit e cila ndërlidhet me aneksin 1 – secifikimet teknike të detyrueshme, mund të konfirmohet që kërkesa e kontestuar nga parashtruesi jo vetëm që ka qenë pjesë e dosjes së tenderit mirëpo e njëjta ka qenë e formuluar po ashtu në mënyrë shumë të kjartë sipas LPP. Për më tepër, parashtruesit kanë pasur mundësi që të kërkojnë edhe sqarime shtesë para hapjes së tenderëve nëse kanë pasur diçka të pakjartë lidhur me këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Përndryshe kërkesa si e tillë është e vendosur pa dyshim në dosjen e tenderit dhe nuk është aspak kontestuese (as për vet parashtruesin) se kjo kërkesë e dosjes së tenderit nuk është përmbushur nga parashtruesi. Rrjedhimisht arsyet për eliminimin e parashtruesit nga aktiviteti i prokurimit sipas njoftimit mbi vendimin dhe rekomandimit të komisionit vlerësues janë qëndrueshme. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore janë në tërësi të pabazuara dhe kërkesa për rishqyrtim duhet të refuzohet si e pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesit nuk kanë paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tyre. Prandaj kërkesat për rishqyrtim të parashtruesve janë refuzuar si të pabazuara në tërësi.

Për pikën I, II dhe III të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.

Për pikën IV dhe V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.04.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës


Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.